

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
SENATI AKADEMIK

Nr. 1092 Prot.

Gjirokastër, më 08.09.2020

V E N D I M

Nr. 26, datë 08.09.2020

P Ë R

MIRATIMIN E RREGULLORES SË SA DHE RREGULLORE E STRATEGJI UGJ

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 33, 38 93, 99, 103, 105, te Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", të Statutit të Universitetit neni 14, 36, 37, 46, 47, 48,54, Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, në mbledhjen e tij të datës 08.09.2020,

V E N D O S I

Të miratoj:

1. Rregulloren e brendshme të Senatit Akademik, e cila hyn në fuqi menjëherë dhe i bashkëlidhet këtij vendimi;
2. Rregulloren e brendshme të përditësuar të Universitetit "Eqrem Çabej", e cila hyn në fuqi me fillimin e vitit akademik 2020-2021 dhe i bashkëlidhet këtij vendimi;
3. Rregulloren e studimeve në UGJ, e cila hyn në fuqi me fillimin e vitit akademik 2020-2021 dhe i bashkëlidhet këtij vendimi;
4. Rregulloren "Për organizimin dhe punën e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë", e cila hyn në fuqi menjëherë dhe i bashkëlidhet këtij vendimi;
5. Rregulloret e brendshme të njësive kryesore dhe njësive bazë, të cilat hyjnë në fuqi me fillimin e vitit akademik 2020-2021 dhe i bashkëlidhen këtij vendimi;
6. Statutin e Këshillit Studentor të Universitetit "Eqrem Çabej", i cili hyn në fuqi menjëherë dhe i bashkëlidhet këtij vendimi;

7. Rregulloren "Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale të Universitetit "Eqrem Çabej", e cila hyn në fuqi menjëherë dhe i bashkëlidhet këtij vendimi;
8. Rregulloren "Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmës Akademike Administrative", e cila hyn në fuqi me fillimin e vitit akademik 2020-2021 dhe i bashkëlidhet këtij vendimi;
9. Rregulloren e njësuar të punës me dokumentet në UGJ, i cili hyn në fuqi menjëherë dhe i bashkëlidhet këtij vendimi;
10. Rregulloren e sekretarisë mësimore, e cila hyn në fuqi me fillimin e vitit akademik 2020-2021 dhe i bashkëlidhet këtij vendimi;
11. Rregulloren për punësimin dhe përzgjedhjen e stafit akademik dhe atij administrativ në universitetin "Eqrem Çabej", e cila hyn në fuqi menjëherë dhe i bashkëlidhet këtij vendimi;
12. Kodin e Etikës ku përfshihet dhe shtojca për kriteret dhe dhe standartet për kontrollin antiplagjiature të disertacioneve të përdorura për marrjen e gradës shkencore në UGJ, i cili hyn në fuqi menjëherë dhe i bashkëlidhet këtij vendimi;
13. Strategjinë për kërkimin shkencor në Universitetin "Eqrem Çabej" (2020-2025) dhe strategjinë e UGJ-së për ndërkombëtarizimin, të cilat hyjnë në fuqi menjëherë dhe i bashkëlidhen këtij vendimi.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

 **Prof.dr.Bektash MEMA**

